

Siguri

Ekskluzive | Sherri për borxhin në Gjakovë eskalon me armë – 53-vjeçari nxori “SIG Sauer”, kanosi dhe goditi me grusht 35-vjeçarin



Sinjali.com

30 Korrik 2026 08:46



Një mosmarrëveshje për një borxh ka përfunduar me kërcënime me armë dhe arrestim në fshatin Bec të Gjakovës.

Sinjali mëson se i arrestuari është **Tush Mulaj (53-vjeç)**, ndërsa viktimë e rastit është **Astrit Gjetaj (35-vjeç)**.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e 29 korrikut, rreth orës 22:00, pasi dy palët kishin lënë takim për të diskutuar lidhur me një borxh.

Gjatë takimit, debati verbal ka eskaluar, ndërsa Tush Mulaj dyshohet se ka nxjerrë një pistoletë të tipit “SIG Sauer” dhe e ka kanosur Astrit Gjetajn.

Në përpjekje për të parandaluar përshkallëzimin e konfliktit, një dëshmitar ka ndërhyrë për t’i ndarë, por i dyshuari dyshohet se e ka goditur me grusht viktimën, pa i shkaktuar lëndime trupore.

Policia ka sekuestruar armën e përdorur në incident, një SIG Sauer, së bashku me 5 fishekë të kalibrit 9×17 mm.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj Tush Mulajt është iniciuar procedurë për veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, “Kanosja” dhe “Sulmi”, ndërsa ai është ndaluar për 48 orë.

Rasti është duke u hetuar nga organet kompetente.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera